



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 2-të të KPF-së Lipjanit mbajtur, më 11.02.2026, në sallën numër 2 , kati i 3-të , me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Armend Grajçevci, anëtar
3. Anila Reçica - Llugiqi, anëtare
4. Elmaze Behluli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Gashi, anëtare
7. Alban Salihu anëtar

Të tjerë prezent :

1. Latif Ramadani, DBF-së
2. Rasim Hasani, DKA
3. Shkelzen Hajdini, DSHPS
4. Bekim Shabani, DP
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Imri Semetishti DUPH

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha ju uroj suksese të rizgjedhurve në KPF, po ashtu edhe anëtarëve të rinjë duke ju dëshiruar suksese. Pastaj tha se rendin e ditës se bashku me material e keni marrë me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja 1 rë.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2025.
3. Propozim Vendim për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës.

4. Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.
5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.
6. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 15Nr.020/04-59398 datë 29.11.2024 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale në Lipjan.
7. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 15Nr.462/01-4918 datë 28.01.2025 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve.
8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.
9. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.
10. Propozim Vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme.
11. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.
12. Propozim Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi- KKSB.
13. Propozim Vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Projekt-Rregullores së re të Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Daut Azemi, tha se kemi edhe 2 pika shtesë, të cilat ua shpërndajti me herët zyrtari i sektorit.

14. Propozim Vendim për emërimin e nënkryetares së komunës për komunitete
15. Propozim Vendim për themelimin e mekanizmit koordinues lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore në Komunën e Lipjanit

Pastaj Kryesuesi tha se po ia kaloj fjalën drejtorit të Shëndetësisë që ta sqaroj pikën e 15-të Propozim Vendim për themelimin e mekanizmit koordinues lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore në Komunën e Lipjanit ku tha se ministria po na obligon që ti formojmë disa komisione siç është ky tani për mbrojtjen e dhunës në familje që përbëhet nga përfaqësues të të gjitha institucioneve.

Arsim Jashari, tha pse se keni lanë për muajin mars këtë pike pasi nuk ka diçka me urgjence po ashtu edhe piken për zgjedhjen e nënkryetarit.

Shkelzen Hajdini, tha e kemi pru tani për shkak se duhet me raportuar 3 mujorin.

Arsim Jashari, tha se sa i përket vendimit për emërimin e nënkryetarit e para se kemi obligim me zgjedh, e dyta nuk duhet të jete nënkryetarja por siç e parasheh ligji nënkryetari edhe titulli nuk është mirë i shkruar duhet të përmirësohet.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se zyra ligjore e ka bërë po konsultona me zyrën ligjore pastaj në Kuvend e diskutojmë.

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi rendin e ditës me pikat e propozuara.

I

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2025.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, tha se a jeni që kjo pikë të shkoj direkt për Kuvend.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se ndryshimi i këtyre hartave nuk mund të bëhet pa u ndryshuar edhe Plani Zhvillimor Komunal. E dyta, nuk e di pse nuk është bërë rregullorja për bonuse pasi që ajo sa do pak do të i lehtësojnë disa qeshtje.

Imri Semetishti, tha se e di që do të ketë sfida por qëllimi më shumë është korrigjimi i disa gabimeve. Nuk kemi muajt ta bëjmë rregulloren për bonuse për shkak se ka disa gabime te rrugët dhe është vështirë të korrigjohen ato.

Arsim Jashari, tha po të bëhej kjo rregullore do të ishte më lehtë sepse ata që nuk janë në zonën e parë do ishe pak me lehtë për ta .

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, drejtor i DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 15Nr.020/04-59398 datë 29.11.2024 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, DUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se duhet qe te jetë një paragraf ku ai qe do të tërhiqet të i ndalet bonusi se paku 3% pasi qe është pune e një komisioni e një kohe të gjate në fund po shkon huq, dhe askush nuk po merr kurrfarë përgjegjësie

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 15Nr.462/01-4918 datë 28.01.2025 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, DUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, DUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se është mirë që është ndryshuar ky vendim pasi që unë edhe mandatin e kaluar kam thane që këto dy vendime duhet të ndahen një për emërtime dhe një për riemërtime .

Imri Semetishti, DUMM, tha se po i kemi ndarë dhe ne si komision do të merremi vetëm me emërtimin e rrugëve të reja.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

IX

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, DUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Imri Semetishti, DUMM, tha se te vendimi duhet të jetë një përmirësim në fund duhet të shtohet Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi Nr.15-020/04-4914 i datës 28.01.2025 për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK në Konjuh.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

X

Propozim Vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Bekim Shabani, drejtor i prokurimit, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

XI

Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

XII

Propozim Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi- KKSB.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

XIII

Propozim Vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Projekt-Rregullores së re të Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, cili ne vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:20

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i KPF-së

Daut Azemi